



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 10 maj 2019.
2. Diskutimi për hapjen e procesit të kandidimit për një vend vakant në Këshillin Drejtues të RTSH-së. Miratimi i Vendimit nr. 10.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fideli Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Klajdi Qama, Kostaq Papa,

Mungojnë:

Fatjona Dhimitri, Ismet Beqiraj, Mirela Kumbaro, Enada Kapllani.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjes të gjithëve.

Para se të fillojmë mbledhjen e sotme, dua t'i uroj mirëseardhjen anëtarit të ri të komisionit, deputetit, z. Kostaq Papa. Mirëse iu bashkuat komisionit tonë. Komisioni ynë është komision atkiv, bëjmë aktivitete, ndjekim kalendarin e Kuvendit, bëjmë kontrolle parlamentar, kështu që do të kemi mjaft punë. Faleminderit që u bëtë pjesë e komisionit.

Kostaq Papa - Ju faleminderit!

Ne vimë këtu për të bërë diçka, për të çuar përpara arsimin shqiptar, parë edhe nga grupet e intersit, por në thelb duke parë çështjen kombëtare të arsimit shqiptar, si prioritet kryesor, duke filluar nga arsimi parashkollor, deri te arsimi plotësues jashtë shtetit, që është për të qarë hallin.

Më vjen mirë që takohem këtu me njerëz që kanë përvojë në këtë fushë, por duhet t'i shtrijmë më realisht dhe më në themel, më praktikisht procedurat dhe problematikat që lidhen me arsimin, sepse ka shumë probleme dhe këtë e shohim edhe nga studentët, këtë e shohim edhe në problematikat në Akademinë e Shkencave. Në gjithçka po të hyjmë, shohim që ka problematika të mëdha. Unë jam këtu vetëm për të punuar, për të përmirësuar diçka dhe për të rënë dakort vetëm për të mirën e kombëtare, jo për të mirën personale apo partiake.

Ju falënderoj.

Milva Ekonomi – Ju faleminderit. I kemi të përbashkëta interesat, për të çuar përpara të mirën kombëtare.

Në rendin e ditës për sot kemi disa çështje për të diskutuar.

E para, a e keni parë procesverbalin e datës 10 maj? Nëse keni ndonjë koment për të bërë, sipas procedurës që kemi ndjekur zakonisht, ju lutem, kalojani me *e-mail* Arianës, për t'u publikuar më tej në Web-in e Kuvendit.

Pika e dytë që ka të bëjë me komisionin sot është një vendim procedural, sepse është krijuar një vend vakant në Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, mandat i një anëtari, që ka përfunduar në fund të prillit, ndaj është koha, madje jemi vonë, për të shpallur vakancën.

Ju e dini se shpallja e vakancës për këtë vend të ri është 30 ditë dhe brenda këtij afati kohor, për çdo vend që hapet, duhet të vinë minimalisht 4 kandidatura. Nëse nuk është plotësuar numri 4, vendimi për hapjen e vakancës rishpallet edhe njëherë. Kështu që për të fituar kohë dhe për ta kryer këtë proces të paktën brenda këtij sesiioni parlamentar, mendoj se sot është data e përshtatshme për të shpallur vakancën dhe besoj se për këtë biem të gjithë dakort, sepse ky është një veprim procedural.

Jeni dakort të gjithë për miratimin e Vendimit nr. 10? Dakort.

T'i lëmë detyrë Shërbimit të Monitorimit dhe sekretarisë sonë që të shpallin vakancën? Në rregull!

Kemi edhe diçka tjetër që lidhet me kalendarin e punës së Kuvendit për disa projektligje që janë në diskutim.

I pari është projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi, që kalon në séance plenare më datë 13 qershor. Në fakt, ne duhet të bëjmë një mbledhje komisioni për këtë qëllim, por do të presim kthimin e kryetares për të zhvilluar mbledhjen. Kështu që pa ardhjen e kryetares, nuk e fillojmë shqyrtimin. Por duke pasur parasysh që më datë 1 qershor fillon fushata elektorale, duhet të kemi parasysh edhe vetë që aktivitetet këtu duhet t'i përmbledhim në 2-3 ditë, që pastaj të mund të punojmë në terren.

Ndërkohë, jemi akoma në pritje të përgjigjes nga Këshilli i Ministrave për projektligjin “Për Akademinë e Shkecape”. Nuk e di se kur përfundon tridhjetëditëshi I pritjes së përgjigjes?

Gazmend Bici – Brenda datës 10 qershor.

Milva Ekonomi – Atëherë ne mund të presim deri më datë 10 qershor.

Tjetër gjë që kemi për të diskutuar është përzgjedhja e kandidaturave për plotësimin e 3 vendeve vakante në KDRTSH, që i takojnë forcës politike të Partisë Socialiste.

Ndërkohë, në Kuvend janë depozituar edhe disa projektligje të tjera, që kanë të bëjnë me komisionin tonë:

Projektligji “Për censin e popullsisë dhe të banesave”, ku jemi komision për dhënie mendimi.

Ariana, ne folëm bashkë dhe u informova që këto projektligje janë në faqen e Kuvendit. Po, na i ke nisur të gjitha.

Sekretarja – Në Kalendarin e Kuvendit janë “punë në komisione”, pra pa afat.

Milva Ekonomi – Kemi edhe projektligjin “Për rininë”, si komision përgjegjës, që edhe ai është “punë në komisione”, pa datë.

Si përherë, kur ka të tilla projektligje, ju kërkojmë ndihmë, juve, të sekretarisë, që të na propozoni një kalendar takimesh dhe pune; pastaj, kur të vijë kryetarja, e diskutojmë.

Pra, në fund të mbledhjes, biem dakort që të shpallim vakancën në KDRTSH dhe të kemi një kalendar të përditësuar nga ju të shërbimit të komisionit.

Me kaq e mbyllim mbledhjen.